



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec



RAHOVEC / ORAHOVAC

NJOFTIM

PËR ORGANIZIMIN E KONSULTIMIT PUBLIK “ONLINE” mbi

Draft-Rregulloren komunale për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme komunale

Komuna e Rahovecit njofton të gjithë qytetarët dhe bizneset për organizimin e debatit publik “online” përmes aplikacionit ZOOM mbi “Draft-Rregulloren për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme komunale”.

Debati publik “online” do të mbahet me datë **28 prill duke filluar nga ora 10:00** dhe të gjithë të interesuarit kanë mundësinë të kyçen në takim përmes aplikacionit ZOOM sipas udhëzime të dhëna në vijim.

- Nëse e keni të instaluar aplikacionin ZOOM, atëherë klikoni këtë link: <https://us02web.zoom.us/j/83121086040> dhe klikoni butonin “Launch Zoom”, apo hapni aplikacionin ZOOM në kompjuter dhe klikoni mbi “Join a meeting” ku shënoni këtë numër identifikues 831 2108 6040 dhe pastaj klikoni mbi butonin “Join”.
- Nëse lidheni përmes browserit (preferohet Google Chrome), atëherë klikoni këtë link: <https://zoom.us/join> e pastaj vendoseni numrin identifikues të dhënë më sipër;

Mirëpo, nëse dëshironi të shkarkoni aplikacionin ZOOM në pajisjet tuaja, në vijim janë listuar hapat që duhet ndjekur për ta instaluar atë:

- Kompjuter, duke shkarkuar aplikacionin ZOOM përmes linkut në vijim <https://zoom.us/client/latest/ZoomInstaller.exe> dhe pastaj aplikacioni i shkarkuar të hapet për ta instaluar aplikacionin.
- Telefon me Android apo Apple iOS, duke hapur PLAY STORE/APP STORE dhe pastaj tek hapësira për kërkim (Search) të kërkohet aplikacioni “ZOOM Cloud Meetings”. Pasi të instalohet aplikacioni në telefonin tuaj, qasja në takim bëhet duke vendosur numrin identifikues të takimit sipas datës dhe orës së dhënë më poshtë.

REND DITE

Debati publik me qytetarë ka për qëllim diskutimin mbi:

1. Draft-Rregulloren për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme komunale”.

Për të pasur qasje në draft-rregulloren në fjalë, ju lutem klikoni në këtë link e publikuar në uebfaqe: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2021/04/Draft-rregullore-komunale-per-percaktimin-e-procedurave-te-dhenies-ne-shfrytezim-me-pak-se-nje-vite-te-prones-se-paluajtshme-komunale.pdf> dhe në platformën e konsultimeve publike: <http://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41090>

